



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1121/9 prot.

Datë 14.05.2025

V E N D I M
Nr. 661/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.05.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër. 1121/2025 prot., datë 02.05.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF41765-03-19-2025, me objekt: “*Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje*”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK me NIPT J64324443V dhe me adresë: Lagjja “18 Tetori”, godinë 1 katëshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, pranë Rotondos së Plukut, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë).

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

II**Rrethanat e çështjes**

II.1. Në datën 20-03-2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e

prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.2. Në datën 02.05.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me nr. 1121/2025, datë 05.05.2025 dhe numër elektronik A/2025/5283, datë 02.05.2025, e operatorit ekonomik “G.P.G. COMPANY” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1121/1 prot, datë 05.05.2025 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

II.4. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shkresës nr.861/8 prot., datë 07.05.2025, protokolluar me tonën me nr.1121/2 prot., datë 08.05.2025 ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se KSHA ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “G.P.G COMPANY” SHPK.

II.5. Në datën 08.05.2025, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik i interesuar “LLAZO” SHPK, ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 1121/3 prot., datë 08.05.2025.

II.6. Në datën 12.05.2025, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues “G.P.G COMPANY” SHPK, me anë të shkresës me objekt “Kërkesë për tërheqje Ankesë nr A2025/5283”, protokolluar me tonën me nr.1121/4 prot., ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, duke u shprehur se:

“Lënda: Kërkesë për tërheqje Ankesë nr A2025/5283

Shoqëria jone ka paraqitur ankesen nr A/2025/5283 prane Autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara dhe Komisionit te Prokurimit Publik me date 02.05.2025, per Objektin e prokurimit: Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje. Kerkojme te tërhiqemi nga shqyrtimi i ankeses sone ne baze të Nenit 105 “Tërheqja e ankimit”, VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, pasi kapacitetet e shoqërisë sonë janë tashme të angazhuara ne një tjetër projekt dhe per pasoje nuk mund te permbushim kushtet e angazhimit të njëkohshëm ne kete procedure prokurimi.”

II.7. Operatori ekonomik ankimues “G.P.G COMPANY” SHPK, nëpërmjet shërbimit postar nëpërmjet shkresës nr. 84 prot., datë 12.05.2025 , protokolluar me tonën me nr.1121/5 prot., datë 13.05.2025 ka dërguar përsëri kërkesën me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, duke u shprehur si më sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues " G.P.G COMPANY " Sh.P.K për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Në datën 12.05.2025, nepermjet sistemit elektornik te ankesave operatori ekonomik ankimues “G.P.G COMPANY” SHPK, me anë të shkresës me objekt “Kërkesë për tërheqje Ankesa nr A2025/5283”, protokolluar me tonën me nr.1121/4 prot., ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, duke u shprehur se:

“Lënda: Kërkesë për tërheqje Ankese nr A2025/5283

Shoqëria jone ka paraqitur ankesen nr A/2025/5283 prane Autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara dhe Komisionit të Prokurimit Publik me date 02.05.2025, per Objektin e prokurimit: Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje. Kërkojme të tërhiqemi nga shqyrtimi i ankeses sone ne baze të Nenit 105 “Tërheqja e ankimit”, VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 “PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, pasi kapacitetet e shoqërisë sonë janë tashme të angazhuara ne një tjetër projekt dhe per pasoje nuk mund te permbushim kushtet e angazhimit të njëkohshëm ne kete procedure prokurimi.”

III.1.2 Operatori ekonomik ankimues “G.P.G COMPANY” SHPK, nëpërmjet shërbimit postar nëpërmjet shkresës nr. 84 prot., datë 12.05.2025 , protokolluar me tonën me nr.1121/5 prot., datë 13.05.2025 ka dërguar përsëri kërkesën me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: “Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje”, me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A, duke u shprehur si më sipërcituar.

III.1.3. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 1121/2025 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues " G.P.G COMPANY " Sh.P.K për procedurën e prokurimit "*E hapur*", me Nr. REF-41765-03-19-2025, me objekt: "*Rikonstruksion i Godinës Qëndrore Spitali Lushnje*", me fond limit 331.458.570,39 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 04.04.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Sh.A.
2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare së paguar nga " G.P.G COMPANY " Sh.P.K
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fioorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

